

JEMI PËR NJËRI-TJETRIN



BARAZIA ËSHTË MES NESH

DUGAGJIN (12), DRILON (13), KASTRIJOT (12), ERJON (12), JONIDA (12), RINESA (13)



Të gjithë fëmijët i kanë të drejtat e barabarta në demokraci, dhe për neve është shumë e rëndësishme që ta dijmë se kush i siguron të drejtat tona. Miratimi ose jo miratimi i tyre bëhet në Kuvend nga deputetët, përfaqësuesit e popullit

Një tregim i shkurtër imagjinar, ku theksohet roli i shoqërisë në demokraci

Një ditë me shokë dhe shoqet shkuam për të vizituar muzeun e Prishtinës. Atje pamë shumë monumente historike. Gjithashtu, pamë vegla që ishin përdorur në kohë të lashta. Shokët e mi, nuk ishin të gjithë të njëjtës përkatësi etnike. Pra, disa ishin shqiptarë e disa të tjerë ashkalinjë. Kur shkuam atje, doli ciceroni që na priti dhe na tregoi më shumë rreth gjërave në muze. Të gjithë flisnim, përveç shokëve ashkalinjë. Ata mbetën disi të humbur, nuk flisnin dhe nuk ndjeheshin mirë. Derisa një shok shqiptar u afrua dhe ju tha të mos rrinin anash, sepse ata ishin të barabartë edhe pse nuk ishin të një përkatësie etnike. Ai na bindi të gjithë shokëve që të mos bënim dallime etnike, duke na treguar se në demokraci të gjithë jemi të barabartë, pa dallime. Kështu, edhe të tjerët filluan ta kuptonin situatën dhe u munduam t'i motivojmë pjesëtarët e komunitetit ashkali duke u shoqëruar me ta, më shumë se më parë.

Kjo ishte një ditë shumë e bukur për të gjithë, sidomos për komunitetin ashkali. Pra, barazia është një element kyç në demokraci.

Edhe në Kuvendin e Kosovës, ku gjithsej janë 120 deputetë, 100 prej tyre janë të kombësisë shqiptare, dhe 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë, siç janë: romë, ashkali, egjiptianë, serbë, turq, boshnjakë dhe



E drejta e kujdesit shëndetësor, e garantuar me ligj


goranë. Duke jetuar në një shtet demokratik, siç është Kosova, duhet të respektojmë njëri-tjetrin, pa dallime gjinore, racore, etnike, etj.



Demokracia mbi të gjitha

DEMOKRACIA E RE

AGNESA (12), ALKETA (12), ARDIT (12), FATJON (12), LENDRIT (13), ZYHRIJE (13)



Ndoshta ju të dashur nxënës, keni mësuar për demokracinë në lëndën e edukatës qytetare. Por, nëse nuk keni mësuar më parë për zhvillimin e demokracisë, atëherë lexoni artikullin tonë


Unë jetoj në një shtet, të cilin e udhëheq një mbret. Fakti që ai është një mbret, që është i pasur dhe që ka të gjithë pushtetin në duart e tij, neve nuk na pëlqen. Babai im punon natë e ditë, por ai nuk punon për neve. I gjithë mundi dhe djersa e tij shkon në duart e mbretit. Unë jetoj në një fshat të varfër. Edhe pse të gjithë punojnë, nuk kemi mjaftueshëm, madje as për të ngrënë. Nëna ime më ka folur shumë rreth familjes mbretërore. Ajo më ka thënë se mbreti do ta ketë këto rol deri sa të vdes. Madje pas vdekjes së tij, pushtetin në duar do ta marrë vajza ose djali i tij. Në këtë shtet, asnjëri nga ne nuk gëzojmë të drejtën e shprehjes së lirë. Si rrjedhojë, asnjëri nga ne nuk kemi të drejtë ta ngrisim zërin kundër ligjeve të mbretit, edhe pse ato nuk janë të duhura për ne. Kështu që ne gjithmonë mbajmë shpresën se një ditë do të mund të flasim lirshëm. Unë shpresoj se fëmijët e mi edhe gjeneratat e ardhshme do të jetojnë në demokraci. Shpresoj se ata do të kenë mundësi që të shprehen lirshëm, që të lëvizin lirshëm dhe që fjala e tyre të ketë sado pak kuptim dhe vlerë në jetën e tyre. Unë nuk iu dëshiroj këtë vetëm fëmijëve të mi, por të gjithë popullit tonë. Të mos harrojmë se i gjithë njerëzimi jeton me këtë shpresë. Andaj, kjo ndjenjë është shumë e rëndësishme. Pas shumë vitesh punë dhe përkushtim, demokracia

do të arrijë edhe në shtetin tim. Bashkëqytetarët që do të lindin pas meje, do ta gëzojnë këtë mënyrë të qeverisjes, kaq shumë të dëshiruar nga ne.

Fjala demokraci rrjedh nga fjalët e vjetra greke që në gjuhën tonë shqupe kanë një kuptim të madh. „Demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë udhëheqje ose fuqi. Demokracia ka prejardhjen pikërisht nga Greqia e lashtë, ku është paraqitur në vitin 507 para erës sonë. Në fillim demokracia ishte direkte, që do të thotë se vetë qytetarët merrnin vendime për të ardhmen e tyre brenda shtetit të tyre. Mirëpo, fatkeqësisht në këtë demokraci gratë, të varfërit, të moshuarit, fëmijët dhe jo vendasit, nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në këtë lloj vendimmarrje. Kurse tash, ne jetojmë në një demokraci përfaqësuese ku kemi të drejtën e votimit, të fjalës së lirë, të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në protesta, peticione, debate, takime, parti politike, etj. Këto të drejta janë të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit për leximin. Mirëupafshim!



Të lumtur dhe demokratikë sa më s'ka



Shoku ynë Fidani është duke zgjedhur mes mollës dhe portokallit. Ai ka të drejtë të zgjedh në jetën e tij të përditshme. Irëpo, kur ai e arrin moshën 18 vjeçare do të mund të jetë pjesëmarrës në procesin zgjedhor



Për të ditur se kush është përfaqësuesi apo përfaqësuesja më e mirë, ne duhet t'i përcjellim fushatat e tyre zgjedhore. Në këto fushata kandidatët e ndryshëm i shpalosin planprogramet e tyre



Të gjithë qytetarët gëzojnë të drejta të barabarta në demokraci. Të gjithë kemi të drejtën e strehimit dhe të votës, pavarësisht fesë, racës, gjinisë, apo ndonjë dallimi tjetër

ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

SOKOL (12), DIELLZA (12), ARBNOR (12), MUHAMET (13), FLORA (13), SARA (12), MAJLIND (12)



Me shumë kënaqësi iu ftojme të gjithëve të mësoni më shumë për zgjedhjet, përmes artikullit tonë

Sot jemi gazetarë të demokracisë. Pasi u shpallëm të fillë nga edukatorët, ne u ndamë edhe në grupe. Edukatorja jonë Blerina, na tregoi se tema e grupit tonë është „Zgjedhjet“. Ajo më pas mori një marker me ngjyrë të kaltër dhe filloi të shënonte rreth temës. Pas pak, ajo zgjodhi një marker tjetër, mirëpo kësaj radhe me ngjyrë të gjelbërt. Më pas na pyeti: „Unë zgjodha



një marker, më pas zgjodha një tjetër. A ndikon kjo zgjedhje e imja në jetën tuaj?“. Pasi u menduam ca sekonda, ne u përgjigjëm dhe thamë se kjo nuk ka si të ndikoj në jetën tonë. Blerina pohoi dhe më pas na pyeti sërish: „Po udhëheqësit e shtetit, a ndikojnë në jetën tonë?“. Ne u menduam përsëri dhe kësaj radhe pohuam se udhëheqësit e shtetit ndikojnë në jetën tonë. Ajo na pyeti si mund të ndikojnë këta udhëheqës

në jetën tonë. Ne i thamë se deputetët përmes ligjeve që miratojnë, i japin kahje jetës sonë. „Prandaj, është shumë e rëndësishme që votën tonë t'ia besojmë kandidatëve të cilët ne i cilësojmë si më të mirët. Meqë këta udhëheqës marrin vendime të rëndësishme për të gjithë, ne duhet të jemi të pjekur dhe kjo është arsyeja pse duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare për të votuar“ na tha Blerina. Kështu ne e kuptuam rëndësinë e procesit zgjedhor, e kuptuam si ndikojnë udhëheqësit e shtetit tek ne dhe pse duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare për të votuar. Ne gjithashtu mësuam se kemi dy lloje të zgjedhjeve në Kosovë. Kemi zgjedhjet lokale, që njihen si komunale, ku qytetarët zgjedhin kryetarët e komunave përkatëse. Si dhe zgjedhjet qendrore apo parlamentare, ku i zgjedhim deputetët. Shpresojmë se e keni kuptuar rëndësinë e votës. Ne jemi udhëheqësit e shtetit tonë dhe këtë e bëjmë duke votuar. Andaj, ta shfrytëzojmë të drejtën e votës dhe të votojmë e të jemi pjesë e vendimmarrjes.



Ne, autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Musa Hoti“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë